

Recension

Një fjalor që u përgjigjet kërkesave të kohës

Mr. Agim Spahiu

11 mars 2002

Përmbledhje

(O. Buchholz, W. Fiedler, G. Ullrich, A. Klosi: **Albanisch- Deutsch; Deutsch- Albanisch, Langenscheidts Handwörterbuch, Berlin 2000, 832 fq.**)

Në këtë shkrim të shkurtër kemi bërë prezantimin e fjalorit voluminoz dhe mjaft të kompletuar gjermanisht- shqip dhe anasjelltas (Albanisch- Deutsch und Deutsch- Albanisch) të autorëve **O. Buchholz, W. Fiedler, G. Ullrich dhe A. Klosi**, botuar nga shtëpia botuese Langenscheidts Handwörterbuch. Ky **Fjalor** është shumë i rëndësishëm për studiues të ndryshëm, albanologë dhe për të gjithë diasporën shqiptare që sot nuk është e pakët në shtetet gjermanishtfolëse.

Botimi i këtij **Fjalori dygjuhësh Albanisch - Deutsch dhe Deutsch - Albanisch**, i cili për një pjesë të konsiderueshme të mërgatës shqiptare që jeton dhe punon në Gjermani dhe në vendet e tjera gjermanofone të Evropës e më gjerë, dhe sidomos për ata që i janë qasur mësimit dhe studimit të gjuhës gjermane, do të konsiderohet si një vepër me rëndësi të veçantë. Është një vepër voluminoze leksikografike dhe tepër e rëndësishme që dallohet nga fjalorët e deritashëm (siç është fjalori i tipit të vogël të A. Hetzer - it Albanisch - Deutsch und Deutsch - Albanisch me 12 mijë fjalë e shprehje, i cili në të shumtën e rasteve gjendet në duart e shqipfolësve, pastaj ai i Z. Simonit etj.). Është ndër fjalorët dygjuhësh më voluminoz për arsye se ky vëllim (pjesa I shqip - gjermanisht ka rreth 30.000 fjalë e shprehje, ndërsa pjesa II gjermanisht - shqip ka, siç thuhet në parathënie, rreth 45.000 fjalë dhe 20.000 frazeologji gjuhësore) ka rreth 100.000 zëra (fjalë e shprehje, njësi frazeologjike, idiomatike etj.) nga këto dy gjuhë.

Pjesa e parë e fjalorit **Albanisch - Deutsch** është botuar më 1990, kurse e dyta **Deutsch - Albanisch** më 1996. Mirëpo të dy pjesët përmbledhen në këtë vëllim të veçantë (që kap rreth 832 faqe) dhe botohet në vitin 2000 nga shtëpia e njohur botuese *Langenscheidts Handwörterbuch* në Gjermani.

Pjesa II, si nga aspekti sasior, por edhe nga ai cilësor, e tejkalon dukshëm pjesën e parë nga shumë anë. Kjo pjesë u hartua nga dy studiues të mëdhenj: nga albanologu gjerman

dr. Wilfried Fiedler dhe studiuesi shqiptar **dr. Ardian Klosi**. Ata në parathënien e kësaj pjese, në mes të tjerash për **Fjalorin** e tyre thonë

se është më i gjeri dhe i pari që vjen si fryt i një bashkëpunimi të ngushtë disavjeçar mes dy folësish amëtarë të secilës gjuhë,

duke shtuar më tutje se

... u përpoqëm që në të të përfshijmë jo vetëm thjesht barazimet gjuhësore, por pikësëpari që ta pasqyrojmë secilën gjuhë si një qenie të gjallë, në këmbimet më të ndryshme sintaksore e stilistike të jetës së sotme, duke mos lënë anash asnjë fjalë a shprehje të rëndësishme që pasqyron jetën kulturore të të dy popujve, qoftë në planin shpirtëror, historik, zakonor, qoftë në atë të kulturës materiale, por kjo vlen edhe për emërtimet më tipike të florës, faunës e gjeografisë së të dy vendeve¹.

Mirëpo kjo nuk do të thotë se pjesa I është për t' u hedhur poshtë. Përkundrazi. Edhe kjo pjesë është shumë e vlefshme dhe e domosdoshme për njerëzit që i mësojnë këto dy gjuhë paralelisht, por më shumë do t' u hyjë në punë albanologëve dhe studiuesve të huaj që përpiqen ta mësojnë shqipen.

Vërejtja kryesore që mund t' i bëhet kësaj pjese të **Fjalorit**, sipas mendimit tonë, është se me rastin e botimit apo të ribotimit të saj, ka pasur mundësi të zgjerohet e të pasurohet paksa me fjalë e shprehje të tjera, duke u mbështetur në një literaturë më aktuale të decenieve të fundit të shekullit që sapo e lamë pas, ngase, sikundër shihet, në literaturën e konsultuar nga albanologët e shquar gjermanë: O. Buchholz, W. Fiedler dhe G. Uhlisch, janë marrë për bazë fjalorët të periudhës nga viti 1954 (Fjalori i gjuhës shqipe; Tiranë, 1954) e deri më 1976 (M. Ndreca, Fjalor shqip - serbokroatisht, Prishtinë, 1976). Pra, në këtë vëllim nuk janë konsultuar fare: **Fjalori i gjuhës së sotme shqipe** (botuar në Tiranë më 1980), **Fjalori i shqipes së sotme** (botuar më 1984) etj. Sido që të jetë, edhe kështu si është, ky Fjalor i ka të gjitha kriteret për të qenë një **Fjalor** i mirë që i përmbush nevojat dhe kërkesat aktuale të kohës së sotme.

Fjalori Albanisch - Deutsch § Deutsch - Albanisch shoqërohet edhe me pjesën gramatikore, në të dy gjuhët, me tabelat e shumta të zgjedhimeve të foljeve, të emrave gjeografikë, të shkurtesave të ndryshme etj.

¹Shih Parathënien e Fjalorit, f. 3.